



Agjencia Kombëtare e Arsimit, Formimit Profesional dhe Kualifikimeve
Drejtoria e Profesioneve dhe Kualifikimeve Profesionale

STANDARDI I KUALIFIKIMIT PROFESIONAL

“SHËRBIME MJETESH TRANSPORTI”

Niveli II në KSHK¹, referuar nivelit II të KEK²

M-II-25

Tiranë 2025

¹ Korniza Shqiptare e Kualifikimeve

² Korniza evropiane e Kualifikimeve

Përmbajtja

Emërtimi i kualifikimit	4
Kodi.....	4
Kohëzgjatja	4
Niveli.....	4
Qëllimi:	4
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	4
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	4
Ofruesit.....	4
Data e validimit.....	5
Data e miratimit	4
Variantet e mëparshme	4
Struktura e kualifikimit	5
Kompetenca të përgjithshme (qëndrimet).....	5
NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:	5
NjN-12-II-0292-25 Vizatimi teknik në shërbime mjetesh transporti	5
Rezultatet e të nxënit në njohuri	6
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	6
Kriteret e vlerësimit	6
NjN-12-II-0293-25 Bazat e mekanikës për mjetet e transportit	7
Rezultate të nxëni në njohuri profesionale.....	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	7
Kriteret e vlerësimit	7
NjN-12-II-0294-25 Organizimi i punës, komunikimi dhe karriera në shërbime mjetesh transporti	7
Rezultate të nxëni në njohuri profesionale.....	7
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	8
Kriteret e vlerësimit	8
NjN-12-II-0295-25 Punime të thjeshta riparimi në motorët e mjeteve të transportit	9
Rezultate të nxëni në njohuri profesionale.....	9
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	10
Kriteret e vlerësimit	10
NjN-12-II-0296-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemin e thithjes dhe shkarkimit të gazrave	10
Rezultate të nxëni në njohuri profesionale.....	10
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	11
Kriteret e vlerësimit	11
NjN-12-II-0297-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemin e transmetimit të fuqisë	11
Rezultate të nxëni në njohuri profesionale.....	11
Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale	12
Kriteret e vlerësimit	12
NjN-12-II-0298-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemin e frenimit.....	13

Rezultate të nxëni në njohuri profesionale.....	13
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	13
Kriteret e vlerësimi	13
NjN-12-II-0299-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemin e drejtimit	14
Rezultate të nxëni në njohuri profesionale.....	14
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	14
Kriteret e vlerësimi	14
NjN-12-II-0300-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemin e varjes dhe të ecjes.....	15
Rezultate të nxëni në njohuri profesionale.....	15
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	15
Kriteret e vlerësimi	15
NjN-12-II-0301-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemet elektrike dhe elektronike	16
Rezultate të nxëni në njohuri profesionale.....	16
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	16
Kriteret e vlerësimi	17
NjN-12-II-0302-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemet ndihmëse.....	17
Rezultate të nxëni në njohuri profesionale.....	17
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	18
Kriteret e vlerësimi	18
NjN-12-II-0303-25 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në shërbime mjetesh transporti	19
Rezultate të nxëni në njohuri profesionale.....	19
Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale	19
Kriteret e vlerësimi.....	19
Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:	20
Modalitetet e vlerësimi	20
Informacion shtesë	21
SHËNIM	21

Emërtimi i kualifikimit	Shërbime mjetesh transporti			Kodi
Kohëzgjatja	2200-3000 nacionale	orë	Niveli	Niveli II në KSHK, referuar nivelit II të KEK
Qëllimi:	Qëllimi i kualifikimit profesional “Shërbime mjetesh transporti”, Niveli II në KSHK , referuar nivelit II të KEK, është të përgatisë punonjës gjysmë të kualifikuar (ndihmës) për shërbime të mirëmbajtjes, riparimit dhe kolaudimit të mjeteve të transportit si dhe të zhvillojë personalitetin e individëve për të jetuar në përshtatje me botën që i rrethon.			
Kriteret e përgjithshme të pranimit:	Në institucionet që ofrohet kualifikimi profesional “Shërbime mjetesh transporti”, Niveli II në KSHK , referuar nivelit II të KEK, kanë të drejtë të regjistrohen të gjithë individët që: - kanë mbaruar arsimin e detyruar 9-vjeçar; - janë në kushte shëndetësore që e lejojnë kryerjen e detyrës për përballimin e kërkesave të këtij niveli të arsimit profesional; - pranohen edhe individë që kanë aftësi ndryshe, për të cilët ofruesi i kualifikimit krijon kushte dhe përshtat programin në përputhje me aftësitë që shfaqin.			
Mundësitë e kualifikimit të mëtejshëm dhe të punësimit:	Përfundimi me sukses i kualifikimit profesional “Shërbime mjetesh transporti”, Niveli II në KSHK , referuar nivelit II të KEK, e pajis individin me Certifikatën Profesionale dhe Suplementin përkatës të nivelit, të punonjësit gjysmë të kualifikuar (ndihmës) në këtë drejtim, të cilat njihen në territorin e Republikës së Shqipërisë. Ky kualifikim i jep individit mundësinë që t'i drejtohet tregut të punës si ndihmës për punësim në subjekte të shërbimeve të riparimit të mjeteve të transportit, të mjeteve bujqësore, të shitjes së pjesëve të ndërrimit si dhe në veprimtari të tjera që veprojnë në këtë drejtim. Me përfundimin e kualifikimit profesional “Shërbime mjetesh transporti”, niveli II në KSHK , referuar nivelit II të KEK, individ ka të drejtë të vazhdojë arsimimin në nivelin III të KSHK, referuar nivelit III të KEK, të kualifikimit profesional (njëvjeçar), të këtij drejtimi. Me arsimim të mëtejshëm në nivelin IV të KSHK-së, referuar nivelit IV të KEK, si teknik /menaxher i mesëm, ai/ajo fiton të drejtën e Diplomës së “Maturës Shtetërore Profesionale” me mundësi për vazhdimin e studimeve pas të mesme dhe/ose universitare.			
Ofruesit	Ky kualifikim duhet të ofrohet nga ofrues të akredituar në zbatim të kuadrit ligjor në fuqi për arsimin dhe formimin profesional.			
Data e validimit	Korrik 2025			
Data e miratimit				
Variantet e mëparshme	M-I-11, M-I-17; M-II-21			

STRUKTURA E KUALIFIKIMIT

Në përfundim të kualifikimit profesional “**Shërbime mjetesh transporti**” **niveli II në KSHK**, referuar nivelit të II të KEK, individit duhet të zotërojë njohuritë, shprehitë profesionale dhe kompetencat e përgjithshme të ndara sipas njësive të të nxënit të mëposhtme:

KOMPETENCA TË PËRGJITHSHME

Rezultatet e të nxënit të kompetencave të përgjithshme janë të vlefshme për të gjitha njësitë e të nxënit.

1. Të komunikojë në mënyrë korrekte me shkrim e me gojë për të shprehur mendimet dhe ndjenjat e tij, si dhe për të argumentuar opinione për çështje të ndryshme;
2. Të përdorë burime dhe teknika të ndryshme të mbledhjes dhe të shfrytëzimit të informacioneve të nevojshme për zhvillimin e tij personal dhe profesional;
3. Të nxisë potencialin e tij/saj të brendshëm në kërkim të vazhdueshëm për zgjidhje të reja më efektive dhe më eficiente;
4. Të angazhohet fizikisht, mendërisht dhe emocionalisht në kryerjen e detyrave të ndryshme në kontekstin profesional, personal dhe shoqëror;
5. Të respektojë rregullat dhe parimet e një bashkëjetese demokratike në kontekstin e integriteteve lokale, rajonale;
6. Të tregojë vetëkontroll gjatë ushtrimit të veprimtarive të tij/saj;
7. Të organizojë drejt procesin e të nxënit të tij/saj, si dhe të shfaqë gatishmëri dhe vullnet për të nxënë gjatë gjithë jetës;
8. Të respektojë parimet e punës në grup dhe të bashkëpunojë aktivisht në arritjen e objektivave të pranuar;
9. Të demonstrojë aftësi për të përmbushur detyrat brenda afateve sipas një plani të caktuar;
10. Të manifestojë guxim dhe aftësi sipërmarrëse për të ardhmen e tij;
11. Të marrë nisma për të bashkëpunuar me individë apo grupe;
12. Të demonstrojë sjellje të përgjegjshme dhe etike në veprimtari shkollore, profesionale dhe komunitet;
13. Të demonstrojë aftësi për të punuar në mënyrë të pavarur dhe për qenë pjesëmarrës pro aktiv në grup;
14. Të pranojë dhe të promovojë risitë dhe ndryshimet;
15. Të vlerësojë dhe vetëvlerësojë nisur nga kritere të drejta si bazë për të përmirësuar dhe çuar më tej arritjet e tij, për t'u përshtatur me evolucionin teknologjik.

NJËSITË E TË NXËNIT TË KUALIFIKIMIT PROFESIONAL:

Standardet e kualifikimit hartohen në bazë të rezultateve të të nxënit (kompetenca të përgjithshme, njohuri dhe shprehje profesionale).

NjN-12-II-0292-25 Vizatimi teknik në shërbime mjetesh transporti

Rezultatet e të nxënit në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë dhe qëllimet e vizatimit teknik;
2. Të listojë veglat dhe pajisjet e vizatimit teknik për të kryer ndërtime gjeometrike dhe vizatime të thjeshta;
3. Të përshkruajë skica detalesh duke përdorur standardet për paraqitjen;
4. Të përshkruajë shënimin e filetave sipas llojit dhe bashkimeve të thjeshta me fileto;
5. Të përshkruajë vizatimet e detaleve të mjeteve të transportit;
6. Të përshkruajë vizatimet e bashkimeve të thjeshta me saldim;
7. Të përshkruajë vizatime të bashkimeve të thjeshta detalesh;
8. Të përshkruajë skemat mekanike dhe kinematike të thjeshta të sistemeve të ndryshme të mjeteve të transportit;
9. Të përshkruajë skemat hidraulike të thjeshta të sistemeve të ndryshme të mjeteve të transportit;
10. Të përshkruajë skemat pneumatike të thjeshta të sistemeve të ndryshme të mjeteve të transportit;
11. Të përshkruajë skemat elektrike dhe elektronike të thjeshta të sistemeve të ndryshme të mjeteve të transportit;
12. Të përshkruajë skema të thjeshta të paraqitura në aksonometri;
13. Të përshkruajë rëndësinë e vizatimeve me kompjuter dhe programet përkatëse.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të analizojë skemat e sistemeve të ndryshme përbërëse të mjeteve dhe motomjeteve të transportit;
2. Të kryejë skica dhe vizatime të thjeshta të detaleve të mjeteve dhe motomjeteve të transportit.

Kriteret e vlerësimit

- Analizon skica ose vizatime detalesh me vështirësi mesatare;
- Vizaton skica të thjeshta detalesh me vështirësi mesatare duke përdorur simbolet sipas standardeve përkatëse;
- Shënon përmasat e skicave të vizatuara sipas standardeve përkatëse;
- Përdor saktë veglat dhe pajisjet e vizatimit teknik për të kryer ndërtime gjeometrike dhe vizatime të thjeshta;
- Analizon vizatimet që përdoren në lidhjet me fileto sipas standardeve;
- Analizon vizatimet e detaleve të mjeteve të transportit sipas standardeve;
- Analizon vizatimet e bashkimeve të thjeshta me saldim sipas standardeve;
- Analizon skemat mekanike dhe kinematike të thjeshta të sistemeve të ndryshme të mjeteve të transportit sipas standardeve;
- Analizon skemat hidraulike të thjeshta të sistemeve të ndryshme të mjeteve të transportit sipas standardeve;
- Analizon skemat pneumatike të thjeshta të sistemeve të ndryshme të mjeteve të transportit sipas standardeve;

- Analizon skemat elektrike dhe elektronike të thjeshta të sistemeve të ndryshme të mjeteve të transportit sipas standardeve;
- Kryen vizatime të thjeshta aksonometrike sipas standardeve.

NjN-12-II-0293-25 Bazat e mekanikës për mjetet e transportit

Rezultate të nxëni në njohuri

1. Të klasifikojë materialet që përdoren në mjetet e transportit sipas proceseve të punës;
2. Të përshkruajë vetitë fizike, kimike dhe mekanike të materialeve;
3. Të përshkruajë veçoritë e metaleve, lidhjeve të metaleve dhe materialeve jometalike;
4. Të përshkruajë detalet, lidhjet dhe mekanizmat që përdoren në mjetet e transportit;
5. Të përshkruajë përdorimin e elementëve hidraulikë dhe pneumatikë në mjetet e transportit;
6. Të listojë metodat kryesore të përpunimit të detaleve;
7. Të përshkruajë veçoritë e statikës, kinematikës dhe dinamikës së trupave;
8. Të shpjegojë kuptimin e koncepteve “ngarkesë” dhe “sforcim” i materialeve;
9. Të përshkruajë tolerancat e përmasave dhe shënimin e tyre në vizatime;
10. Të përshkruajë veçoritë e sistemit ISO të tolerancave dhe vendosjeve;
11. Të përshkruajë punime të thjeshta të axhusterisë sipas procesit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të klasifikojë materialet që përdoren në mjetet e transportit;
2. Të përzgjedhë detalet, lidhjet, mekanizmat dhe llojet e transmisioneve;
3. Të përcaktojë tolerancat e përmasave dhe vendosjes sipas standardit;
4. Të kryejë llogaritje të thjeshta për ngarkesat dhe sforcimet e materialeve.

Kriteret e vlerësimit

- Klasifikon materialet që përdoren në mjetet e transportit sipas proceseve të punës;
- Përcakton saktë vetitë fizike, kimike dhe mekanike të materialeve;
- Përcakton saktë veçoritë e metaleve, lidhjeve të metaleve dhe materialeve jometalike;
- Zbaton metodat kryesore të përpunimit të detaleve, sipas udhëzimeve;
- Përzgjedh detalet, lidhjet, mekanizmat dhe llojet e transmisioneve sipas llojit të mjetit të transportit;
- Kryen saktë llogaritje të thjeshta që kanë të bëjnë me ngarkesat dhe sforcimet e materialeve,
- Përcakton saktë tolerancat e përmasave dhe shënimin e tyre, sipas standardit;
- Përcakton saktë tolerancat e vendosjeve sipas standardit.

NjN-12-II-0294-25 Organizimi i punës, komunikimi dhe karriera në shërbime mjeteve të transportit

Rezultate të nxëni në njohuri

1. Të përshkruajë strukturën organizative të një servisi automjeteve;

2. Të klasifikojë llojet e motomjeteve dhe automjeteve sipas ndërtimit dhe funksionit të tyre;
3. Të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e pjesëve kryesore të një automjeti dhe motomjeti;
4. Të shpjegojë qëllimin dhe përmbajtjen e librit të shërbimeve të automjetit;
5. Të përshkruajë llojet e shërbimeve në mjetet e transportit dhe rëndësinë e tyre;
6. Të identifikojë programet elektronike që përdoren për diagnostikim dhe riparime në autoservis;
7. Të përshkruajë rëndësinë e rregullave të sigurisë gjatë vendosjes së automjetit dhe motomjetit në urë;
8. Të listojë mjetet, veglat, pajisjet dhe materialet që përdoren në një servis, sipas funksionit;
9. Të përshkruajë procedurat e kontrollit vizual të automjeteve dhe motomjeteve para fillimit të punës;
10. Të përshkruajë mënyrat për sistemimin dhe pastrimin e vendit të punës;
11. Të shpjegojë radhën e punës për procese të thjeshta;
12. Të përshkruajë mënyrat dhe rëndësinë e bashkëpunimit me eprorët dhe kolegët;
13. Të përshkruajë rëndësinë e raportimit mbi ecurinë e punës;
14. Të listojë rregullat bazë të komunikimit verbal dhe jo verbal me eprorët dhe kolegët;
15. Të përshkruajë parimet kryesore të punës në grup dhe rëndësinë e zbatimit të tyre;
16. Të përshkruajë domosdoshmërinë e respektimit të hierarkisë;
17. Të përshkruajë parimet bazë të kodit të etikës në punë;
18. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të terminologjisë profesionale gjatë punimeve në repart;
19. Të përshkruajë rëndësinë e përdorimit të teknologjisë së informacionit dhe komunikimit;
20. Të përshkruajë rëndësinë e respektimit të barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare etj.;
21. Të përshkruajë rëndësinë dhe metodat e zhvillimit profesional;
22. Të përshkruajë rëndësinë e analizimit të vetvetes;
23. Të përshkruajë mënyrat e informimit për teknologjinë dhe programet e reja;
24. Të listojë llojet e trajnimeve dhe kurseve të ndryshme për zhvillimin e karrierës.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë radhën e punës për detyrën e dhënë;
2. Të përdorë mjetet, materialet dhe pajisjet e thjeshta të punës;
3. Të raportojë tek eprori për punën e kryer;
4. Të zbatojë rregullat e komunikimit etik dhe profesional gjatë punës;
5. Të kryejë trajnime të vazhduara profesionale.

Kriteret e vlerësimit

- Merr detyrën e dhënë nga eprori;
- Përcakton radhën e punës për realizimin e proceseve të thjeshta sipas detyrës së dhënë;
- Lexon librin e shërbimit të motomjeteve dhe automjeteve, sipas rregullores së brendshme;
- Përgatit motomjetet dhe automjetet për shërbim sipas procedurave përkatëse;
- Kryen kontrollin vizual të motomjeteve dhe automjeteve nga jashtë dhe brenda, sipas

procedurave përkatëse;

- Përcakton mjetet, materialet dhe pajisjet e thjeshta të punës sipas llojit të shërbimit;
- Përdor mjetet, materialet dhe pajisjet e thjeshta të punës sipas llojit të shërbimit;
- Merr pjesë në kontrollin e funksionalitetit të mjeteve dhe pajisjeve të punës sipas manualeve përkatëse;
- Kryen sistemimin dhe pastrimin e vendit të punës sipas rregullores së brendshme;
- Bashkëpunon me eprorët dhe kolegët sipas procedurave përkatëse;
- Raporton punën e kryer sipas formateve përkatëse;
- Zbaton saktë rregullat e komunikimit verbal dhe jo verbal .
- Zbaton kodin e etikës dhe rregullat e hierarkisë në komunikimin me eprorët dhe kolegët;
- Merr udhëzime vazhdimisht nga eprorët për realizimin e detyrës;
- Zbaton vazhdimisht teknologjitë e reja të informacionit dhe komunikimit;
- Përdor rregullisht terminologji profesionale;
- Vepron/komunikon në përputhje me parimet e barazisë gjinore, racore, kombëtare, kulturore, fetare dhe të tjera;
- Identifikon nevojat për trajnim;
- Përcakton saktë burimet dhe metodat e zhvillimit profesional;
- Informohet vazhdimisht për teknologjitë dhe programet e reja;
- Ndjek vazhdimisht trajnime dhe kurse të ndryshme profesionale.

NjN-12-II-0295-25 Punime të thjeshta riparimi në motorët e mjeteve të transportit

Rezultate të nxëni në njohuri

1. Të listojë llojet e motorëve me djegie të brendshme (MDB) sipas përdorimit;
2. Të përshkruajë ndërtimin e automjeteve Hibride dhe Elektrike;
3. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e mekanizmave dhe sistemeve të MDB;
4. Të përshkruajë llojet e lëndëve djegëse të MDB dhe karakteristikat e tyre;
5. Të përshkruajë kuptimin e parametrave teknike dhe konstruktiv të MDB dhe motorëve elektrik HV;
6. Të përshkruajë mënyrat e kontrollit vizual dhe dëgjimorë të motorit;
7. Të përshkruajë elementët e sistemit të ftohjes në MDB sipas funksionimit;
8. Të përshkruajë elementët e sistemit të vajosjes në MDB sipas funksionimit;
9. Të listojë karakteristikat teknike të vajit dhe filtrave sipas përdorimit;
10. Të përshkruajë llojet dhe përdorimin e lëngjeve ftohëse sipas funksionimit;
11. Të përshkruajë procedurat e ndërrimit të vajit dhe filtrave në MDB;
12. Të listojë llojet e sistemeve të ushqimit;
13. Të listojë llojet e rripave të transmissioinit sipas parametrave dhe përmasave të tyre.
14. Të përshkruajë llojet dhe përdorimin e pulexhove dhe regjistruerëve të rripave, sipas funksionimit;
15. Të përshkruajë procedurën e kontrollit të nivelit dhe cilësisë së lëngjeve ftohëse dhe vajrave;

16. Të përshkruajë elementet e thjeshtë konstruktive, llojet dhe funksionimin e tyre;
17. Të përshkruajë punime të thjeshta të çmontim/montimit të elementeve të thjeshtë konstruktive të MDB;
18. Të përshkruajë llojet e shërbimeve të thjeshta të mirëmbajtjes në motor dhe rëndësinë e tyre.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë kontrolle vizuale dhe dëgjimore në sistemet e MDB-së;
2. Të kryejë punime të thjeshta në sistemet e MDB-së;
3. Të kryejë punime të mirëmbajtjes në MDB.

Kriteret e vlerësimit

- Klasifikon motorët me djegie të brendshme (MDB) sipas llojit;
- Klasifikon lëndët djegëse të MDB sipas karakteristikave teknike;
- Merr pjesë në kontrollin e parametrave teknike dhe konstruktiv të MDB dhe motorëve elektrik HV, sipas udhëzimeve;
- Kryen kontrollin vizual dhe dëgjimor të motorit, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e sistemit të ftohjes në MDB sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e sistemit të vajosjes në MDB sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e sistemit të ushqimit sipas udhëzimeve;
- Përzgjedh rripat e transmisionit, sipas parametrave teknik;
- Zëvendëson rripat e transmisionit sipas udhëzimeve;
- Përzgjedh pulexhot dhe regjistruesit e rripave, sipas parametrave teknik;
- Zëvendëson pulexhot dhe regjistruesit e rripave, sipas udhëzimeve;
- Kryen kontrollin e nivelit të vajit dhe lëngut ftohës sipas udhëzimeve dhe procedurës;
- Kryen punime të thjeshta të çmontim/montimit të elementeve të thjeshtë konstruktive të MDB, sipas udhëzimeve;
- Kryen punime të mirëmbajtjes në motor sipas udhëzimeve.

NjN-12-II-0296-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemin e thithjes dhe shkarkimit të gazrave

Rezultate të nxëni në njohuri

1. Të përshkruajë elementet e sistemit të thithjes së motorit, ndërtimi dhe funksionimi i tij;
2. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e turbos/kompresorit, radiatorit ftohës të ajrit dhe pjesëve ndihmëse;
3. Të përshkruajë funksionin dhe ndërtimin e kolektorit të thithjes, si dhe rolin e farfallave të përshpejtimit;
4. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e EGR (riqarkullimi i gazrave të shkarkimit);
5. Të përshkruajë rëndësinë e matësit të sasisë së ajrit dhe sensorit të presionit në kolektorin e thithjes;
6. Të përshkruajë punime të thjeshta në elementët e sistemit të thithjes;

7. Të përshkruajë punime të thjeshta të elementëve të sistemit të shkarkim-monitorimit të gazrave;
8. Të përshkruajë sistemin e shkarkim-monitorimit të gazrave, sipas funksionimit dhe ndërtimit të tyre;
9. Të përshkruajë procedurat e punimeve të pastrimit në sistemin e thithjes si dhe në sistemin e shkarkim-monitorimit të gazeve.
10. Të përshkruajë procedurat e kontrollit pamor dhe dëgjimor të sistemit të thithjes dhe shkarkim-monitorimit të gazrave;
11. Të listojë parregullsitë e mundshme në sistemin e thithjes dhe shkarkim-monitorimit të gazrave;
12. Të përshkruajë llojet e shërbimeve të thjeshta të mirëmbajtjes në sistemin e thithjes dhe shkarkim-monitorimit të gazrave.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë kontrollin vizual dhe dëgjimor në sistemin e thithjes dhe shkarkim-monitorimit të gazrave;
2. Të kryejë punime të thjeshta në sistemin e thithjes dhe shkarkim-monitorimit të gazrave;
3. Të kryejë punime të mirëmbajtjes në sistemin e thithjes dhe shkarkim-monitorimit të gazrave.

Kriteret e vlerësimit

- Kryen kontrollin vizual dhe dëgjimor në sistemin e thithjes, sipas udhëzimeve;
- Kryen kontrollin vizual dhe dëgjimor në sistemin e shkarkim-monitorimit të gazrave, sipas udhëzimeve;
- Kryen çmontim/montimin e elementëve në sistemin e thithjes, sipas udhëzimeve;
- Kryen riparimin/zëvendësimin e elementëve në sistemin e thithjes, sipas udhëzimeve;
- Kryen çmontim/montimin e elementëve në sistemin e shkarkim-monitorimit të gazrave, sipas udhëzimeve;
- Kryen riparimin/zëvendësimin e elementëve në sistemin e shkarkim-monitorimit të gazrave, sipas udhëzimeve;
- Kryen punime të thjeshta të pastrimit të elementëve të sistemit të thithjes, sipas udhëzimeve;
- Kryen punime të thjeshta të pastrimit të elementëve të sistemit të shkarkim-monitorimit të gazrave, sipas udhëzimeve;
- Kryen punime të mirëmbajtjes në sistemin e thithjes sipas udhëzimeve;
- Kryen punime të mirëmbajtjes në sistemin e shkarkim-monitorimit të gazrave sipas udhëzimeve.

NjN-12-II-0297-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemin e transmetimit të fuqisë

Rezultate të nxëni në njohuri

1. Të përshkruajë elementet e sistemit të transmetimit të fuqisë, ndërtimi dhe funksioni i tyre;
2. Të përshkruajë konceptin mbi parametrat teknik të fuqisë;
3. Të listojë llojet e volanteve sipas funksionit dhe ndërtimit të tyre;

4. Të listojë llojet e friksionit sipas funksionit dhe ndërtimit të tij;
5. Të përshkruajë mënyrën e funksionimit të mekanizmit të komandimit të friksionit sipas llojit dhe ndërtimit të tij, si dhe pjesët përbërëse;
6. Të përshkruajë procedurat e kontrollit, punime të thjeshta të elementëve përbërës të friksionit dhe sistemit të komandimit të friksionit;
7. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e kutisë së ndërrimit të shpejtësisë sipas llojeve të tyre;
8. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e kutisë shpërndarëse ndërmjetëse sipas llojeve të tyre;
9. Të përshkruajë procedurat e kontrollit dhe riparimit të kutisë shpërndarëse ndërmjetëse;
10. Të listojë llojet e hidroshundës sipas funksionimit të tyre;
11. Të listojë llojet e nyjeve (xhantot) kardanike, ndërtimi dhe funksionimi i tyre;
12. Të përshkruajë procedurat e kontrollit, çmontimit/montimit dhe riparimit/zëvendësimit të nyjeve (xhantot) kardanike;
13. Të listojë llojet e boshteve dhe gjysmë boshteve të transmetimit, ndërtimi dhe funksionimi i tyre;
14. Të përshkruajë procedurat e kontrollit, çmontimit/montimit dhe riparimit/zëvendësimit të boshteve dhe gjysmë boshteve të transmetimit;
15. Të listojë llojet e diferencialit, ndërtimi dhe funksionimi i tij;
16. Të përshkruajë procedurën për kontrollin dhe riparimin e diferencialit;
17. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e kuzhinetave të rrotës sipas llojit;
18. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e mocos së rrotës, llojet e tyre;
19. Të përshkruajë procedurat e kontrollit, çmontimit/montimit dhe riparimit/zëvendësimit të kuzhinetës dhe mocos së rrotës;
20. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionin e kutisë së ndërrimit të shpejtësisë (kambios automatike) llojet;
21. Të përshkruajë procedurën e kontrollit/zëvendësimit të nivelit të vajit në kutitë e ndërrimit të shpejtësisë dhe diferencialit;
22. Të përshkruajë karakteristikat teknike të vajrave që përdoren në kutitë e ndërrimit të shpejtësisë dhe diferencialit;
23. Të përshkruajë llojet e shërbimeve të thjeshta të mirëmbajtjes në sistemin e transmetimit të fuqisë.

Rezultatet e të nxënit në shprehje profesionale

1. Të kryejë kontrollin vizual dhe dëgjimor në sistemin e transmetimit të fuqisë;
2. Të kryejë punime të thjeshta në sistemin e transmetimit të fuqisë;
3. Të kryejë punime të mirëmbajtjes në sistemin e transmetimit të fuqisë.

Kriteret e vlerësimit

- Kryen kontrollin vizual të të dhënave teknike të sistemit të transmetimit të fuqisë, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në përcaktimin e parregullsive në sistemin e transmetimit të fuqisë, sipas

udhëzimeve;

- Merr pjesë në çmontim/montimin e volantit, friksionit dhe hidrohuntos, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin e volantit, friksionit dhe hidrohuntos, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e mekanizmit të komandimit të friksionit sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin e mekanizmit të komandimit të friksionit, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e kutisë së shpejtësisë, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin e kutisë së shpejtësisë, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e kutisë ndërmjetëse, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin e kutisë ndërmjetëse, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e xhuntove kardanike, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin e xhuntove kardanike, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e diferencialit, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin e diferencialit, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e boshteve dhe gjysmë boshteve, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin e boshteve dhe gjysmë boshteve, sipas udhëzimeve;
- Kryen punime të mirëmbajtjes në sistemin e transmetimit të fuqisë sipas udhëzimeve.

NjN-12-II-0298-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemin e frenimit

Rezultate të nxëni në njohuri

1. Të përshkruajë ndërtimin, elementët dhe funksionimin e sistemit të frenimit;
2. Të përshkruajë procedurat e kontrollit dhe riparimit të diskut të frenave, tamburove, ferrodave, pistonçinave dhe tubave të alkoolit;
3. Të përshkruajë procedurat e kontrollit, riparimit dhe regjistrimit të sistemit të frenave të dorës;
4. Të përshkruajë procedurat e kontrollit dhe riparimit të depresorit të frenave;
5. Të përshkruajë llojet dhe karakteristikat teknike të alkoolit të frenave;
6. Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të alkoolit të frenave;
7. Të përshkruajë llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes në sistemin e frenimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë kontrollin vizual dhe dëgjimor në sistemin e frenimit;
2. Të kryejë punime të thjeshta në sistemin e frenimit;
3. Të kryejë punime të mirëmbajtjes në sistemin e frenimit.

Kriteret e vlerësimit

- Merr pjesë në kontrollin e sistemit të frenimit, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e diskut të frenave, tamburove, ferrodave, pistonçinave dhe tubave të alkoolit sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin e diskut të frenave, tamburove, ferrodave, pistonçinave dhe

tubave të alkoolit sipas udhëzimeve;

- Merr pjesë në çmontim/montimin e sistemit të frenave të dorës (stacionare) sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin dhe regjistrimin e frenave të dorës (stacionare) sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e depresorit të frenave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin e depresorit të frenave sipas udhëzimeve;
- Kryen kontrollin e nivelit të alkoolit të frenave sipas udhëzimeve dhe procedurës;
- Kryen punime të thjeshta të mirëmbajtjes në sistemin e frenimit.

NjN-12-II-0299-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemin e drejtimit

Rezultate të nxëni në njohuri

1. Të përshkruajë funksionimin e sistemit të drejtimit të automjeteve dhe motomjeteve të transportit;
2. Të përshkruajë llojet dhe funksionimin e përforcuesve të sistemit të drejtimit të mjeteve të transportit;
3. Të përshkruajë metodat e kontrollit vizual dhe dëgjimor të sistemit të drejtimit të mjeteve të transportit;
4. Të përshkruajë metodat e kontrollit, çmontimit, montimit dhe riparim/zëvendësimit të akseve dhe kokave të paralelit të sistemit të drejtimit të mjeteve të transportit;
5. Të përshkruajë metodat e kontrollit, çmontimit, montimit dhe riparim/zëvendësimit të përforcuesve të sistemit të drejtimit të mjeteve të transportit;
6. Të përshkruajë rëndësinë e procedurës së konvergjencës së sistemit të drejtimit të mjeteve të transportit;
7. Të përshkruajë llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes në sistemin e drejtimit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë kontrollin vizual dhe dëgjimor në sistemin e drejtimit;
2. Të kryejë punime të thjeshta në sistemin e drejtimit;
3. Të kryejë punime të mirëmbajtjes në sistemin e drejtimit.

Kriteret e vlerësimit

- Analizon saktë dokumentacionin teknik të sistemit të drejtimit të mjeteve të transportit;
- Kontrollon librin e shërbimeve të mjeteve të transportit, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin vizual dhe dëgjimor të sistemit të drejtimit, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në përcaktimin e parregullsisë në sistemin e drejtimit, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e përforcuesve të sistemit të drejtimit, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin e përforcuesve të sistemit të drejtimit sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e akseve dhe kokave të paralelit, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin e akseve dhe kokave të paralelit sipas udhëzimeve;

- Raporton te eprori për përfundimin e procesit të riparim/zëvendësimit, sipas formateve;
- Merr pjesë në kryerjen e procesit të konvergjecës;
- Kryen punime të thjeshta të mirëmbajtjes në sistemin e drejtimit.

NjN-12-II-0300-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemin e varjes dhe të ecjes

Rezultate të nxëni në njohuri

1. Të klasifikojë llojet e sistemeve të varjes dhe të ecjes;
2. Të përshkruajë parametrat teknike të elementëve përbërës të sistemit të varjes dhe të ecjes;
3. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e elementëve të sistemit të varjes dhe të ecjes;
4. Të përshkruajë gomat, karakteristikat teknike dhe përdorimin e tyre;
5. Të përshkruajë kontrollin e dadëkëve, presionit të ajrit dhe trashësisë së batistradës së gomës;
6. Të përshkruajë procedurat e riparim/zëvendësimit të gomës dhe diskut të rrotës;
7. Të përshkruajë amortizatorët, ndërtimin, funksionimin dhe procedurat e zëvendësimit të tyre;
8. Të përshkruajë krahët lëkundës, ndërtimin, funksionimin dhe procedurat e zëvendësimit të tyre;
9. Të përshkruajë stabilizatorët, ndërtimin, funksionimin dhe procedurat e zëvendësimit të tyre;
10. Të përshkruajë sustat, ndërtimin, funksionimin dhe procedurat e zëvendësimit të tyre;
11. Të përshkruajë balestrat, ndërtimin, funksionimin dhe procedurat e riparim/zëvendësimit të tyre;
12. Të përshkruajë jastëkët e ajrit, ndërtimin, funksionimin dhe procedurat e zëvendësimit të tyre;
13. Të përshkruajë llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes në sistemin e varjes dhe të ecjes.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë kontrollin në sistemin e varjes dhe të ecjes;
2. Të kryejë punime të thjeshta në sistemin e varjes dhe të ecjes;
3. Të kryejë punime të mirëmbajtjes në sistemin e varjes dhe të ecjes.

Kriteret e vlerësimit

- Lexon saktë dokumentacionin teknik të sistemit të varjes dhe të ecjes;
- Merr pjesë në kontrollin e dadëkëve, ventilit, të presionit të ajrit dhe trashësisë së batistradës së gomës, sipas udhëzimeve;
- Kryen kontrollin e gomave, sipas udhëzimeve;
- Kryen çmontim/montimin e gomave sipas udhëzimeve;
- Kryen riparim/zëvendësimin e gomave sipas udhëzimeve;
- Kryen kontrollin e diskut të rrotës, sipas udhëzimeve;
- Kryen çmontim/montimin e diskut të rrotës sipas udhëzimeve;
- Kryen riparim/zëvendësimin e diskut të rrotës sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin vizual të amortizatorëve, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin dhe zëvendësimin e amortizatorëve, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin vizual të sustave, sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin dhe zëvendësimin e sustave, sipas udhëzimeve;

- Merr pjesë në kontrollin e krahëve lëkundës dhe stabilizatorëve sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin dhe zëvendësimin e krahëve lëkundës dhe stabilizatorëve sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e balestrave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin dhe riparim/zëvendësimin e balestrave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e jastëkëve të ajrit sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin dhe zëvendësimin e jastëkëve të ajrit sipas udhëzimeve;
- Kryen punime të thjeshta mirëmbajtjeje në sistemin e varjes dhe të ecjes.

NjN-12-II-0301-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemet elektrike dhe elektronike

Rezultate të nxëni në njohuri

1. Të përshkruajë kuptimin mbi rrymën elektrike dhe parametrat e saj;
2. Të përshkruajë konceptet e rrymës alternative dhe asaj të vazhduar;
3. Të lexojë elementet e një qarku të thjeshtë elektrik;
4. Të klasifikojë llojet e baterive që përdoren në automjete;
5. Të shpjegojë ndërtimin dhe funksionin e baterive;
6. Të përshkruajë procedurën e zëvendësimit ose karikimin e një baterie;
7. Të përshkruajë llojet e alternatorëve, karakteristikat, ndërtimin dhe funksionimin e tyre.
8. Të përshkruajë procedurën e kontrollit dhe zëvendësimit të alternatorit;
9. Të përshkruajë funksionin, ndërtimin dhe karakteristikat e motorinos;
10. Të përshkruajë procedurën e kontrollit dhe zëvendësimit të motorinos;
11. Të klasifikojë llojet e përcjellësve elektrikë sipas përdorimit dhe dimensionet përkatëse të tyre;
12. Të përshkruajë procedurën e kontrollit dhe zëvendësimit të përcjellësve elektrikë;
13. Të përshkruajë elementët e sistemit të ndezjes dhe funksionin e secilit;
14. Të përshkruajë procedurën e kontrollit dhe zëvendësimit të elementëve të sistemit të ndezjes;
15. Të listojë llojet e llambave dhe portollambave sipas funksionit të tyre;
16. Të përshkruajë procedurën e kontrollit dhe zëvendësimit të llambave dhe portollambave;
17. Të klasifikojë fenerët dhe stopat sipas llojit dhe funksionit të tyre;
18. Të përshkruajë procedurën e kontrollit dhe riparim/zëvendësimit e fenerëve dhe stopave;
19. Të përshkruajë funksionin dhe llojet e siguresave në sistemin elektrik;
20. Të përshkruajë procedurën e kontrollit dhe zëvendësimit të siguresave;
21. Të listojë llojet e sensorëve, sipas funksionit;
22. Të përshkruajë vepruesit (aktuatorët), llojet dhe funksionet e tyre;
23. Të klasifikojë paketat elektronike në automjet, llojet dhe funksionimin e tyre;
24. Të përshkruajë procedurën e kontrollit dhe zëvendësimit të sensorëve, vepruesve dhe paketave elektronike;
25. Të përshkruajë llojet e shërbimeve të mirëmbajtjes në sistemet elektrike dhe elektronike të automjetit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë kontrollin në sistemin elektrik dhe elektronik;
2. Të kryejë punime të thjeshta në sistemin elektrik dhe elektronik;
3. Të kryejë punime të mirëmbajtjes në sistemin elektrik dhe elektronik.

Kriteret e vlerësimit

- Merr pjesë në kontrollin e gjendjes teknike të baterisë sipas udhëzimeve;
- Kryen zëvendësimin ose karikimin e baterisë sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e alternatorit (gjeneratorit të tensionit) sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e alternatorit (gjeneratorit të tensionit) sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në zëvendësimin e alternatorit (gjeneratorit të tensionit) sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e motorinës sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e motorinës sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në zëvendësimin e motorinës sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e llambave dhe portollambave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e llambave dhe portollambave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në zëvendësimin e llambave dhe portollambave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e fenerëve dhe stopave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e fenerëve dhe stopave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin e fenerëve dhe stopave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e siguresave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në zëvendësimin e siguresave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e sensorëve, paketave elektronike dhe të vepruesve sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e sensorëve, paketave elektronike dhe të vepruesve sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në zëvendësimin e sensorëve, paketave elektronike dhe të vepruesve sipas udhëzimeve;
- Kryen shërbime të thjeshta të mirëmbajtjes në sistemet elektrike dhe elektronike sipas standardeve teknike.

NjN-12-II-0302-25 Punime të thjeshta riparimi në sistemet ndihmëse

Rezultate të nxëni në njohuri

1. Të listojë sistemet ndihmëse të automjeteve, funksioni dhe ndërtimi i tyre;
2. Të përshkruajë ndërtimin, skemën e funksionimit dhe elementët përbërës të sistemit të ajrit të kondicionuar;
3. Të përshkruajë parametrat teknikë të elementëve përbërës të sistemit të ajrit të kondicionuar;
4. Të përshkruajë llojet e gazeve ftohëse dhe karakteristikat teknike të tyre;
5. Të përshkruajë procedurat e zëvendësimit të gazit ftohës;
6. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e mekanizmit të fshirëseve të xhamave;

7. Të përshkruajë ndërtimin dhe funksionimin e mekanizmit të hapjes së xhamave;
8. Të përshkruajë procedurat e kontrollit dhe riparim/zëvendësimit të sediljeve dhe rripave të sigurimit;
9. Të përshkruajë procedurat e kontrollit dhe zëvendësimit të parakolpit dhe prapakolpit;
10. Të përshkruajë procedurat e kontrollit dhe zëvendësimit të pasqyrave;
11. Të listojë shërbime të thjeshta mirëmbajtjeje në sistemet ndihmëse të automjetit.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të kryejë kontrollin në sistemet ndihmëse;
2. Të kryejë punime të thjeshta në sistemet ndihmëse;
3. Të kryejë punime të mirëmbajtjes në sistemet ndihmëse.

Kriteret e vlerësimit

- Lexon saktë dokumentacionin teknik për sistemet ndihmëse të automjeteve;
- Lexon saktë dokumentacionin teknik për sistemin e ajrit të kondicionuar;
- Lexon saktë dokumentacionin e gazeve ftohëse;
- Merr pjesë në kontrollin e filtrit të gazit të ajrit të kondicionuar sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e filtrit të gazit të ajrit të kondicionuar sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në zëvendësimin e filtrit të gazit të ajrit të kondicionuar sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e kompresorit të ajrit të kondicionuar sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e kompresorit të ajrit të kondicionuar sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në zëvendësimin e kompresorit të ajrit të kondicionuar sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e gjendjes së gazit në sistemin e ajrit të kondicionuar sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në mbushjen me gaz të sistemit të ajrit të kondicionuar sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e mekanizmit të fshirëseve të xhamave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e mekanizmit të fshirëseve të xhamave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në zëvendësimin e mekanizmit të fshirëseve të xhamave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e mekanizmit të hapjes së xhamave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e mekanizmit të hapjes së xhamave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në zëvendësimin e mekanizmit të hapjes së xhamave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e sediljeve dhe rripave të sigurimit sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e sediljeve dhe rripave të sigurimit sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në riparim/zëvendësimin e sediljeve dhe rripave të sigurimit sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e parakolpit dhe prapakolpit sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e parakolpit dhe prapakolpit sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në zëvendësimin e parakolpit dhe prapakolpit sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në kontrollin e pasqyrave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e pasqyrave sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në zëvendësimin e pasqyrave sipas udhëzimeve;

- Merr pjesë në kontrollin e elementëve të impiantit të fonisë sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në çmontim/montimin e elementëve të impiantit të fonisë sipas udhëzimeve;
- Merr pjesë në zëvendësimin e elementëve të impiantit të fonisë sipas udhëzimeve;
- Kryen shërbime të thjeshta të mirëmbajtjes në sistemet ndihmëse.

NjN-12-II-0303-25 Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në shërbime mjetesh transporti

Rezultate të nxëni në njohuri

1. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave të sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit;
2. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave të sigurisë dhe mbrojtjes kundër zjarrit në vendin e punës;
3. Të përshkruajë llojet e pajisjeve të MZSH³ dhe përdorimin e tyre;
4. Të përshkruajë procedurat e evakuimit, llojet e emergjencave, sinjalistikën dhe protokollet përkatëse të tyre;
5. Të listojë aksidentet kryesore që mund të ndodhin gjatë veprimtarisë së kryerjes së shërbimeve të mjeteve të transportit duke shpjeguar mënyrën e shmangies së tyre;
6. Të përshkruajë mënyrat e dhënies së ndihmës së shpejtë në rastet e ndryshme të aksidenteve në punë;
7. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të rregullave të mbrojtjes së shëndetit në punë dhe dokumentacionin e detyrueshëm;
8. Të përshkruajë rreziqet kryesore të ndotjes së ambientit dhe masat përkatëse për eliminimin e ndotjes;
9. Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me energji elektrike;
10. Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me ngarkesa dhe pesha të rënda;
11. Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik të ruajtjes, magazinimit dhe gjatë kryerjes së punimeve me lëngje të ndryshme (vaj, alkool, lëndë djegëse, etj.);
12. Të përshkruajë mënyrën dhe rëndësinë e ndarjes së mbetjeve të ndryshme në autoservis;
13. Të përshkruajë rregullat e sigurimit teknik gjatë kryerjes së punimeve me gaz;
14. Të përshkruajë rëndësinë e zbatimit të protokolleve në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Rezultatet e të nxënit në shprehi profesionale

1. Të zbatojë standardet dhe rregullat e sigurimit teknik në punë;
2. Të zbatojë procedurat për mbrojtjen e shëndetit në punë dhe higjienës personale;
3. Të respektojë procedurat për mbrojtjen e mjedisit dhe zhvillimin e qëndrueshëm;
4. Të zbatojnë protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Kriteret e vlerësimit

- Zbaton masat për garantimin e sigurisë në punë dhe mbrojtjes së mjedisit në shërbimet e

³ Mbrojtja ndaj zjarrit dhe shpëtimi

mjeteve të transportit;

- Zbaton sinjalistikën në mjediset e punës;
- Përdor pajisjet e MZSH;
- Zbaton procedurat e evakuimit në raste emergjente;
- Përdor mjetet e domosdoshme për dhënien e ndihmës së parë në raste aksidenti;
- Respekton rregullat për një mjedisi të qëndrueshëm;
- Zbaton rregullat e sigurisë për automjetet që punojnë me tension të lartë;
- Zbaton rregullat gjatë përdorimit të solucionëve me përmbajtje kimike;
- Zbaton rregullat e ndarjes, depozitimit dhe magazinimit të mbetjeve dhe materialeve;
- Zbaton protokollet e duhura në raste të gjendjes së jashtëzakonshme.

Njësitë e të nxënit, peshat dhe kodet përkatëse:

Nr.	Njësi të nxëni	Peshat në %	Kodet
1	Vizatimi teknik në shërbime mjetesh transporti	6	NjN-12-II-0292-25
2	Bazat e mekanikës për mjetet e transportit	9	NjN-12-II-0293-25
3	Organizimi i punës, komunikimi dhe karriera në shërbimin e mjeteve të transportit	4	NjN-12-II-0294-25
4	Punime të thjeshta riparimi në motorët e mjeteve të transportit	15	NjN-12-II-0295-25
5	Punime të thjeshta riparimi në sistemin e thithjes dhe shkarkimit të gazrave	9	NjN-12-II-0296-25
6	Punime të thjeshta riparimi në sistemin e transmetimit të fuqisë	9	NjN-12-II-0297-25
7	Punime të thjeshta riparimi në sistemin e frenimit	9	NjN-12-II-0298-25
8	Punime të thjeshta riparimi në sistemin e drejtimit	9	NjN-12-II-0299-25
9	Punime të thjeshta riparimi në sistemin e varjes dhe të ecjes	9	NjN-12-II-0300-25
10	Punime të thjeshta riparimi në sistemet elektrike dhe elektronike	9	NjN-12-II-0301-25
11	Punime të thjeshta riparimi në sistemet ndihmëse	9	NjN-12-II-0302-25
12	Siguria në punë dhe mbrojtja e mjedisit në shërbime mjetesh transporti	3	NjN-12-II-0303-25
	Totali	100	

Modalitetet e vlerësimit

Me vlerësim kuptojmë procesin gjatë të cilit mblidhen të dhëna dhe gjykohet për vlerën e arritjes së një rezultati të nxëni (RN), mbi bazën e kritereve të caktuara.

Për vlerësimin mund të përdoren një shumëllojshmëri metodash standarde dhe inovatore.

Individi i nënshtrohet vlerësimit të vazhduar, përmbledhës dhe vlerësimit përfundimtar për kualifikimet formale që ofrohen në ofrues të akredituar.

Individi vlerësohet për shkallën e përvetësimit të kompetencave të përgjithshme dhe profesionale, të nevojshme për të punuar në veprimtari të ndryshme profesionale që operojnë në fushën përkatëse dhe vihet theksi te verifikimi i shkallës së arritjes së RN për realizimin e tërësisë së proceseve duke mbajtur evidenca për qëllime dokumentimi.

Realizimi i pranueshëm do të konsiderohet arritja e kënaqshme e të gjitha kriterëve të specifikuar. Dhënia e rezultatit të vlerësimit bëhet sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Kompetencat e përgjithshme vlerësohen të integruara si pjesë e vlerësimit të njësive të të nxënit. Individi i lind e drejta të certifikohet për njësi të nxëni specifike, si një kualifikim i pjesshëm sipas kuadrit ligjor në fuqi.

Informacion shtesë

Kualifikimet e plota ose të pjesshme profesionale mund të përftohen nëpërmjet këtyre formave:

- a) ndjekjes së arsimit profesional me bazë shkollën;
- b) ndjekjes së kurseve profesionale, ku përfshihen edhe praktikat profesionale në ndërmarrje apo forma të tjera të mësimnxënies praktike;
- c) regjistrimit si nxënës, duke u punësuar në një ndërmarrje (forma e dyfishtë);
- ç) njohjes të të nxënit të mëparshëm informal dhe joformal;
- d) njohjes të të nxënit të përfutur jashtë vendit;
- dh) formave të tjera të përcaktuara me ligj.

SHËNIM

Shpjegime të kodit të kualifikimit: **M-II-25**

M – Shkronja që identifikon fushën e kualifikimit profesional

II – Shifra që identifikon nivelin sipas KSHK -së

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar kualifikimi profesional

Shpjegime të kodit të njësisë së të nxënit: **NjN-12-II-0292-25**

NjN – Shkronjat që tregojnë se kodi i referohet Njësive të të Nxënit

12 – Numri që identifikon fushën e Njësisë së të Nxënit

II – Shifra që tregon nivelin e Njësisë së të Nxënit në strukturën e KSHK -së

0292 – Numri rritës progresiv që tregon gjendjen e Njësive të të Nxënit në ditën e hartimit përkatës

25 – Shkurtimi i vitit kalendarik kur është hartuar/rishikuar Njësia e të Nxënit